



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.605/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kompanisë private N.SH.T- D.HHED, me seli në Suharekë, paraqitur kundër Sali Zyba, kandidat për kryetar komune në komunën e Suharekës nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Suharekë, për shkak të vendosjes së posterit në objekt privat, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 04.10.2021, mori këtë:

### VE N D I M

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.605/2021 e datës 30.10.2021, e paraqitur nga kompania private N.SH.T-D.HHED, me seli në Suharekë, ndaj Sali Zyba, kandidat për kryetar komune në komunën e Suharekës nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Suharekë, për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

### A r s y e t i m

Me datën 30.09.2021, kompania private N.SH.T- D.HHED, me seli në Suharekë, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se kjo kompani është kompani marketingu dhe ka në shfrytëzim hapësirën publike për 10 vite rresht të Kuvendit Komunal të Suharekës ku për këtë është votuar në Kuvendin Komunal të Suharekës, mirëpo në këtë hapësirë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka vënë reklamë dhe i ka cenuar kështu punën dhe veprimtarinë kësaj kompanie duke vendosur murale në pronën private të tyre ashtu që të njëjtit si kompani i ka shkaktuar dëme.

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi kësaj ankese i ka bashkangjitur edhe dy fotografi të printuara.

PZAP-i me datën 30.09.2021, ka dërguar subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kërkesën për përgjigje në ankesë në të cilën i ka kërkuar që të përgjigjet deri me datë 01.10.2021 deri në ora 09:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 30.09.2021, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), thekson se pretendimet e ankuesit janë të pa bazuara për faktin se për shfrytëzimin e hapësirës private për qëllime reklamuese të cekur në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka arritur marrëveshje me Frutex sh.p.k në cilësinë e pronarit të objektit ku është vendosur posterit kontestues. Andaj parashtruesi i përgjigjes në ankesë i ka propozuar PZAP që ta refuzojë ankesën si të pabazuar.

Përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur Marrëveshjen për shfrytëzimin e aseteve (vendosjen e reklamës në hapësirat e objekteve) të datës 25.09.2021 e cila në nenin II e ka të theksuar se

LVV-dega Suharekë dhe Frutex sh.p.k pajtohen që të vendosin reklama në objektin afarist në Rr. "Brigada 123" Suharekë me detaje të specifikuara dhe se kjo marrëveshje vlen gjer me datë 17.11.2021.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se kompania private N.SH.T- D.HHED, me seli në Suharekë ka në shfrytëzim hapësirën publike për 10 vite rresht të Kuvendit Komunal të Suharekës, dhe se në këtë hapësirë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka vënë reklamë posterin e kandidatit Sali Zyba, kandidat për kryetar komune, dhe me këtë i ka cenuar kështu punën dhe veprimtarinë kësaj kompanie duke vendosur murale në pronën private të tyre, janë të pabazuara, dhe nuk përbëjnë shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi posterit i kandidatit Sali Zyba, kandidat për kryetar komune në Komunën e Suharekës është i vendosur në prone private që rezultojnë e vendosur sipas marrëveshjes së arritur me kompaninë Frutex sh.p.k dhe subjektit politik LVV dega ne Suharekë. PZAP rikujton se nuk është e kompetencën e këtij institucioni që të vlerësoj se vendosja e kësaj reklame a është në përputhje me rregulloret e nivelit të komunës, nga se çështja e tille duhet të vlerësohet nga ana e organeve Komunale.

Paneli po ashtu pas shqyrtimit të kësaj ankesë e duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së "vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse" vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që ankesa e parashtruesit ka qene sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, pasi që në momentin kur kompania private N.SH.T- D.HHED, pretendon se ka në shfrytëzim hapësirën publike për 10 vite rresht të Kuvendit Komunal të Suharekës, është e detyruar që nëpërmjet provave të vërtetoj faktin e pretenduar, se e ka në shfrytëzim hapësirën private në të cilën pretendon se është vendosur posterit reklamues i kandidatit Sali Zyba, kandidat për kryetar komune në Komunën e Suharekës nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës se këto veprime përbëjnë shkelje nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje pasi që posterit në fjalë është i vendosur në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të posterave sipas marrëveshjes së arritur në mes të kompanisë Frutex sh.p.k, dhe subjektit politik LVV dega në Suharekë ashtu siç vërtetohet edhe nga Marrëveshja për shfrytëzimin e aseteve e datës 25.09.2021 për vendosjen e reklamës në hapësirat e objekteve.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.605/2021 më datën 04.10.2021



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.